

VENDIM
Nr. 133, datë 22.2.2012

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE (OBJEKTE) QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT
RRUGOR QUKËS-QAFË-PLLOÇË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik” dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private (objekte), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Qukës-Qafë-Plloçë.
 2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 6 891 530.5 (gjashtë milionë e tetëqind e nëntëdhjetë e një mijë e pesëqind e tridhjetë pikë pesë) lekësh.
 4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 225 000 (dyqind e njëzet e pesë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.
 5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 6 891 530.5 (gjashtë milionë e tetëqind e nëntëdhjetë e një mijë e pesëqind e tridhjetë pikë pesë) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2012, zëri “Investime”, miratuar për Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve.
 6. Shpronësimi të fillojë nga data 1.3.2012.
 7. Pronari i objektit, për të cilin është bërë shënimi “Proces regjistrimi”, të likuidohet, për efekt shpronësimi, pasi të përfundojë procesi i regjistrimit, fakt i cili do të konfirmohet zyrtarisht nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Librazhd, si dhe në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë që do të dorëzojë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
 8. Pronarët e përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmohet nga ZVRPP-ja”, të kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
 9. Pronari i objektit, për të cilin është bërë shënimi “Proces legalizimi”, do të likuidohet, për efekt shpronësimi, nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar.
 10. Pronari i objektit, për të cilin është bërë shënimi “Leje ndërtimi”, do të likuidohet, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit tekniko-ligjor që do të dorëzojë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
 11. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve, në bazë të pikave 7, 8, 9 dhe 10 të këtij vendimi.
 12. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha